



Dalës-izlezyr

Nr. -11-142 Data 01.02.2023
Br. Datum

OPŠTINA OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



ZYRA E KRYETARIT
Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008), nenit 11 paragrafi 11.20 të Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-081 dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, pas kërkesës së DSHMS-së, Kryetari i Komunës me datë 31.01.2023 merr këtë:

VENDIM
Për lejimin e mjeteve

- I. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale , për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për familjet strehuese në Komunën e Obiliqit, të cilat përkujdesen për fëmijë të braktisur.
- II. Lejohen mjetet në vlerë prej 200€ (dyqind euro) për çdo muaj për familje që strehon dhe përkujdeset për fëmijë të braktisur.
- III. Shuma e lejuar si në pikën 2 të këtij vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - subvencionet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
- IV. Ky vendim vlen për periudhë një vjeçare dhe aplikohet në mënyrë retroaktive nga 1 janar 2023 deri me 1 dhjetor 2023.
- V. Obligohet Drejtorija e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, QPS-ja dhe DEFZH-ja për zbatimin e këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit.

T'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- DSHMS-së dhe DEFZH-së;
- QPS-së;
- Arkivit.

Kryetari i Komunës
Xhafer Gashi

